Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË KORNIZË PËR PËR SHERBIME

KOMUNA E ISTOGUT-Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson U.D. i Menaxher-it te Prokurimit, Gëzim Ademaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

Arton Zeqiraj B.I., DPSH "ARTONI" Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. Arton Zeqiraj, ne cilësinë e Drejtorit me nr. te Rexh. Biznesit 810298100 (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për sherbimet e shënuara me poshtë:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE TË INSTITUCIONEVE KOMUNALE LOT 1

Nr. I prokurimit	**633-20-7024-221/FA071 – lot 1**
Nr. I brendshëm	**633 / 020 / 113 / 221**

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE TË INSTITUCIONEVE KOMUNALE LOT 1

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 2 DITË pas porosisë së Autoritetit Kontraktues. nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe të lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, për çdo kerkese veq e veq.

2.2 Vendi i dorëzimit të sherbimev do të jenë Autoriteti Kontraktues në Istog-Parku i automjeteve.

2.3 Inkotermi1 i zbatueshëm do të jetët *DDP*

Neni 3 Origjina

3.1Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjën e kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet total I kësajë kontrate për pagesë është: **46.288,47 €**

"Katërdhjetegjashtëmijëedyçindetetëdhjetetetëeuro-47/100

42. Oferta financijare e furnitorit e datës **12.11.2020** është pjesë përberese e kësajë kontrate dhe bazë për pagesën e furnitorit.

4.3 Vlera kontraktuese e kësajë kontrate. mund te ketë devijim + - **30% sipas dispozitave te LPP-së**

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kjo marrëveshje e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare;

Plani per menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kurdo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe **fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.**

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: **Komuna e Istogut**		*Për Kontraktorin:* **ARTON ZEQIRAJ DPSH "ARTONI"**	
Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Arton Zeqiraj***
Pozita:	***U.D. I Menaxheri-it të Prokurimit***	***Pozita:***	***P r o n a r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	16. 12. 2020	***Data:***	16. 12. 2020
Vula		***Vula***	D. P. SH. - AUTOSERVIS "ARTONI" BANJE

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPSTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës	5.4	Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë. Sherbimet nga O.E. do te ekzekutohen maksimumi 5dite nga dhenia e urdherit per blerje. Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej **24** muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: caktohet nga ZKA
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 1 muaj me gjate se perfundimi i kontrates.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	*Permes Zyres se Prokurimit*
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohetGjykaten ekonomike ne Pr. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [*specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)*].